



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Seancat e gjykimit në çështjen gjyqësore të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit rifillojnë të hënën tjetër, më 10 nëntor. Të hënën seanca fillon në orën 14:00 dhe përfundon në orën 17:00. Seanca janë planifikuar edhe për të martën, të mërkurën dhe të enjten, nga ora 09:00 deri në orën 16:30 çdo ditë.

Mbrojtja e Thaçit ka thirrur katër dëshmitarë deri më sot, dhe sipas parashtrimeve publike aktuale, synon të thërrasë edhe tre dëshmitarë të tjerë në kuadër të paraqitjes së provave të saj.

Më 4 nëntor, Trupi Gjykses miratoi kërkesa të Mbrojtjes së Thaçit në lidhje me javën pas javës së ardhshme dhe dëshminë e Uesli Klarkut (Wesley Clark), i cili është dëshmitari i fundit që Mbrojtja e Thaçit planifikon të thërrasë.

Pasi u informua se dhënia e dëshmisë së tij mund të fillojë vetëm pasditen e 18 nëntorit dhe pasi shqyrtoi përllogaritjet e palëve në lidhje me kohëzgjatjen e parashikuar të pyetjeve të tyre, Trupi Gjykses miratoi kërkesën e Mbrojtjes për rezervimin e një dite shtesë për seancë gjyqësore më 21 nëntor, për të përfunduar dhënien e dëshmisë dhe miratoi shtimin e një deklarate me shkrim të dëshmitarit në listën e provave të Mbrojtjes.

Informacionin më të fundit në lidhje me seancat e planifikuara mund ta gjeni në kalendarin e gjykatës në faqen e internetit të DHSK-së, në të tri gjuhët zyrtare të Gjykatës.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 4 nëntor, Trupi Gjykses lëshoi një vendim me të cilin hodhi poshtë një kërkesë të ekipeve të Mbrojtjes për të apeluar pranimin si prova të një videoincizimi dhe të faqeve të një dokumenti që Prokuroria e paraqiti kur mori në pyetje dëshmitarin e parë të thirrur nga Mbrojtja e Thaçit. Në vendim, gjykatësit dhanë arsye të hollësishme përse konstatuan se pikat e ngritura nuk ishin të apelueshme.

Gjithashtu më 4 nëntor, Trupi Gjykses lëshoi vendim mbi një kërkesë të paraqitur në shtator nga Mbrojtja e Thaçit, për konstatim të shkeljeve nga Prokuroria në nxjerrjen e materialeve sipas rregullës 102(3). Trupi Gjykses vuri në dukje se "respektimi i plotë dhe në kohë nga Prokuroria i detyrimit të saj për nxjerrjen e materialeve është element dhe garanci e rëndësishme për drejtësinë e procesit dhe barazinë midis palëve, ZPS-së dhe Mbrojtjes". Trupi Gjykses konstatoi se ZPS-ja nuk i kishte dhënë Mbrojtjes njoftim të hollësishëm për disa materiale dhe prova në posedim të saj dhe gjykatësit i kujtuan ZPS-së rëndësinë e përfshirjes së





materialeve në njoftimin sipas rregullës 102 (3). Njëkohësisht, Trupi Gjykses konstatoi se materialet ishin nxjerrë pa vonesë dhe nuk i kishin shkaktuar dëm Mbrojtjes, dhe e hodhi poshtë kërkesën.

Në çështjen gjyqësore të Hashim Thaçit, Isni Kilajt, Bashkim Smakajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit, në lidhje me pretendime për ndikim të paligjshëm ndaj dëshmitarëve, këtë javë u bënë publike një numër vendimesh me të cilët u miratuan masa hetimore të posaçme në vitin 2023. Këto vendime mund t'i gjeni në faqen e internetit.

Kujtojmë se në Aktakuzë, kundër të akuzuarve janë ngritur akuza për vepra penale që lidhen me përpjekje të paligjshme për të ndikuar në dëshmitë e dëshmitarëve në gjykimin *Thaçi dhe të tjerët* për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Sipas Aktakuzës së Konfirmuar, midis së paku 12 prillit dhe 2 nëntorit 2023, gjatë vizitave të veçanta, të paprivileguara, në objektin e paraburgimit, z. Thaçi u dha z. Smakaj, z. Kilaj, z. Fazliu dhe z. Kuçi informacion konfidencial për dëshmitarë të Prokurorisë, i udhëzoi të ndikonin në dëshmitë e dëshmitarëve të Prokurorisë dhe u dha hollësi si ta bënë këtë.

Duke iu përgjigjur pyetjes së një gazetari, zëdhënësi shpjegoi se:

“Një letër nga Kryeministër Kurti i është dërguar Kryetares në Shtator 2022 dhe ajo iu përgjigj kësaj letre. Kryetarja në përgjithësi ka theksuar në përgjigje se DHSK-ja dhe gjykatësit janë të pavarur në punën e tyre dhe se ata po zhvillojnë gjykimet sipas kornizës ligjore të DHSK-së dhe standardeve më të larta të të drejtave të njeriut. Ajo gjithashtu ka theksuar se vendimet në lidhje me paraburgimet merren nga trupat gjykses kompetentë në çdo çështje gjyqësore, dhe jo nga Kryetarja.”

